

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H-1  
532



**FAIK DEDA**

Liggjëratë  
kroi

**POEZI**

814-1  
832

FAIK  
DEDA



LIGJËRATË  
KROI

Poezi



12055

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1978

## TE VARREZAT E DËSHMORËVE

... Trëndafila të kuq pranë lapidarit tuaj,  
Partia sokoleshë namin se ç'ua rriti,  
nëpër zemrat tona lëvrin gjaku juaj,  
thurin ligje nënat, malli ç'i zhuriti...

Nis këngën rapsodi, kënga s'di të ndalet,  
gëzimi nga gjokset derdhet gurgullimë.  
O, kjo melodi, e dhemshur si malet,  
me gjakun ndër zemra krejt natyrshëm hyn.

– Ç'u përzhite flak' e tym,  
po s'të tuti gjylja, zjarri;  
Shqipëri, shpatëvetëtimë,  
syrin me çika stralli!

## M Ë N G J E S

Kroi buzë ledhit s'lodhet, flet e flet,  
nis bilbili këngën tutje në korie.  
Dielli thotë heshtas – unë jam mbret,  
syr' i tij i madh, përmbi kodrat bie...

Me tingujt e radios udhët ngado mbushen;  
gur më gur sorkadhia, lulet behin.  
Vashat ngjitin bregun, ja ku duken,  
ku lulet e blirit edhe gurët dehin...

## KUR S'KISHIM TË NESËRME

...Hallet s'na shqiteshin.  
Për një kafshatë dhe pafillen me dhallë,  
shojet e këmbëve na plasariteshin  
gjith' ditën e ditës nëpër zall.

Mes lëngatës sonë,  
dhe krojet qenë tharë...

Gllënjkat e hidhërimit gurmazin na vrisnin,  
duke u dridhur rreth vatrës i kaptonim.

Të nesërme – nuk kishim,  
për të nesërmen mendonim!...

## A R O M Ë

Era sjell nga fushat aromë tërfili,  
noton kal' i qyqes mbi hone e pyje;  
një leshverdhë lesën e avllisë mbylli  
dhe ndaloi vrapin tutje në korie...

Nër ugare bredhin pëllumbat e hirtë,  
zën'e zgjaten hijet, cula qesh e qan...  
Vjen një erë kulpri nga burim i çiltër,  
ku edhe gjinkalla, tjetër iso mban...

## SYRI I PUSHKËS

Nat' e ditë ndër gryka, me pushkën qafuar  
përgjonte shqiptari, qafash, në ahishte;  
në rrebeshe kohërash, mirë e kish mësuar  
tyt' e pushkës ç'thoshte, tyt e pushkës ç'ishte.

Plumbat – llohë të vinin, çfarëdo që të ndodhte  
baras me dy sytë, syn' e pushkës kishte;  
atë sy s'kish lodhje që të mund ta lodhte,  
çdo stuhi të sulej, çfarëdo mot të vinte.

Vetëm ai sy kurrë nuk do lotonte,  
askush syn' e pushkës kurrë nuk do t'ia mirrte.  
Qerpiku qerpikun s'mundej ta takonte  
n'atë sy që armikun mu në ballë e shihte!



## KUR MË PËRCOLLI NËNA

...Qe një dit' shtatori atë mot,  
kur më përcolli nëna për qytet,  
një torbë me pemurina mbushi plot,  
tund e tund krahun te një plep...

## ME MENDJE TË KTHJELLUAR

Sa më pëlqen, o sa më pëlqen mëngjesi!...  
Drejt shullërit ngjiten bagëtia;  
mantel' e natës mali e zhveshi,  
këmisha t'ylberta veshi gjithësia...

Kodrash e mbi lugje, i kthjelluar  
vështrimi im në dehje po kundron;  
në zemër ndiej diçka të pashpjeguar,  
një brohori në shpirt po më ushton...

Si mijëra bij e bija më çda anë,  
mes bujqve kam ardhur përgjithmonë.  
Të thjeshtët e të dashurit fshatarë,  
këngën morën siç e kanë zakon.

Krahëhapur në mes tyre un' u derdha,  
më pritën porsi bir e me gëzim të valë;  
si gurgullimë përroi tek burimi erdha,  
u bëra «njëzet vjeç djalë»...

## FLLADI I AGIMIT

Zbret ledheve dita e nata shtyhet honeve;  
qielli,  
bririn e argjendtë rrëzon prapa malesh.  
Flladi, yjet që çlodhen gjoleve  
ëmbël i përkund nëpër djepe valësh...

Hijet e natës  
po i fshin dalngadalë mëngjesi,  
Çafkëlori mbi qershi  
aq bukur këndon...  
Gjyshi prapë këndon.:  
Gjyshi prapë çibukun e ndezi,  
shpërveshi krahët  
dhe me qetë në brinjë po lëron.

## NË ÇDO STUHI

Liria, që nga nëntori ynë i parë,  
binjake vigjilencën mban përherë;  
nëpër rrebesh, gjëmim edhe acar,  
syri ynë s'ka fjetur asnjëherë.

Partia çdo sekondë mban peshën e vetë malit,  
me gjykimn' e thellë zaptin çdo lartësi;  
praktika e saj ka pastërtinë e kristalit,  
përmbi tallaze,  
në çdo stuhi.

## PAS KTHIMIT NGA PUNA

Nga të korrat vashat ja tek vijnë,  
ky gëzim' i punës ndër sy bulëzon;  
nis një valle tej në bokërimë,  
fëshfërimë plepash, kroi ligjëron...

Shpejton dallëndyshja të vijë në fole,  
te vatr' e kulturës rinia nxiton;  
ngado po përhapet kënga «Si lum ne...»,  
tutje, përmbi lisa ngrihet një shqiponjë.

## PO VIJ TEK TI

Po vij tek ti,  
s'e duroj dot largësinë...  
Lumturinë tonë të bardhë,  
buzëqeshjen dhe bukurinë,  
pranë teje t'i kundroj.

Të shoh atë sy,  
që askund s'mund ta harroj...

Me frymën time  
ato bulëza djerse që rrjedhin si elmaze,  
nga balli t'i largoj.

Peizazhin me brezare  
pas qerpikësh ta dalloj...

## UDHËT TONA

E shtrenjtë për çdo cantim, moj toka shqiptare,  
gatuan edhe ndez ti vrullin proletar;  
kështjellë që shkëlqen e ngrihesh mbi tallaze,  
horizontesh hap udhët diell-larë.

Marksizëm-leninizmi ciklonesh lartësohet,  
pranverat socialiste s'kanë tek ne mbarim.  
Vrull' i shqipeve furtunave forcohet,  
del mbi çdo majë,  
çan në çdo rrethim. ,

## GJAKU I RI

Në çdo celulë të jetës, ne gjithnjë punojmë  
të vijë veç gjak i pastër në gjoksin tënd, Parti;  
si jetën e sa jetën këtë gjak e çmojmë,  
ndaj dhe skleroza kurrë nuk do na vijë.

Ky gjak merr oksigjen nga gjiri yt i kthjellët,  
ti e mbrun çdo hap me të klasës frymë;  
Atdheu ynë i dashur, i ri do mbesë përherë,  
Diell' i komunizmit  
nuk do njohi brymë!



## MOS KËRKO TË DUKESH

Mos kërko të dukesh kur bën diçka të mirë;  
e mira nuk ka fund, gjith' jetën do punuar.  
«Ka hesap udh' e Kolonjës, bir,  
dhe mali s'ngjitet aq kollaj kaluar...»

## NGA KJO BALTË

Ja hën' e florinjte s'e mbyll syn' e shkruar,  
me atë dritë të njohur që derdh në çdo anë;  
honi i yjeve-ushtri e harbuar,  
në pika kristali ndriçon anembanë.

Njerëzit ëndërrojnë kudo nëpër botë,  
po mendimet e mia nga kjo baltë burojnë.  
Njerëzit, si malet këtu janë të fortë;  
pavdekësinë e jetës –  
malet dëshmojnë.



12055

## MARTESA E DJESHME

Brenga për të nesërmen mes hidhërimit dridhej,  
ankim' i drojtur shkiste nëpër buzë.  
Në lep' e peqe jet' e gruas mblidhej,  
jet' e saj e zezë –  
mbështillej në tërkuzë.

## DY DITË PAS MARTESËS

Kjo gushë e bukur  
larë në flori;  
as na fol një fjalë,  
si në çupëri...

– Unë një fjalë e fola,  
n'ato bokërima:  
– Hapuni, ju sarra,  
se vjen gjeraqina!

Udhë e mbarë, o krushka,  
për në shtëpinë tuaj;  
nesër do dal herët,  
grurin ta bëj duaj.

Atje, tok me shoqet  
gëzimin e gjejmë;  
ato bokërima  
n'tarraca do kthejmë.

Me shok' e me shoqe,  
pa zbardhur agimi,  
lugjet edhe ledhet  
do mbuloj gëzimi...

## LIGJËRATË KROI

Këtë mbrëmje ngjyrë ari shkrirë,  
një kënge për bukën ia merr dhe bujqit shtruar,  
pastaj, me moshatarët, shetisim nër çairë,  
gëzim' i jetës sonë s'ka të mbaruar...

Ngjyr' e trëndafiltë kodrat ledhatoi,  
mbrëmja hap pa bujë vazon e argjendtë...  
lehtas ia thonë vashat-ligjëratë kroi;  
pjeshkës porsaçelur diç i ra ndër mend...

## VARRI I TEZES SIME

Aty pran' plepit është varr' i tezes sime,  
që vdiq e ve, e mjerë e zemër përvëlur;  
– Moj e shkreta, teze!... Akoma në mendime  
për atë që kockat la në dhe të huaj?!

Aty rrotull plepit, bari fërfërin;  
një gushkuq te shtogu s'bëka hiç rehat...  
– Teze, moj, akoma në përgjim  
mos vjen kurbetçiu që s'nisi një kartë?!

Tutje atij plepi ngrihet një godinë,  
mbi çatinë e kuqe një antenë zbardhon;  
sipër saj shpesh pëllumbat rrinë,  
vështrojnë nga plepi, plepi fërfëron...

## P E I Z A Z H

Blegërijnë qingjat tek hidhen poshtë e lart,  
aq bukur u këndoi gojëmbli Naim...  
Arishteve bredhin mëzat harrakat,  
ca fëmijë shkasin në një bokërimë.

Bujqit eshkën dhe hurorët nxjerrin,  
pamëndat lanë të bëjnë pak pushim.  
Një traktor duke ngjitur ledhin,  
kollitet e gërhet me nxitim.



## UDHA E KOMUNISTËVE

Përherë në gji të masës, ku djersa rrjedh si lumë,  
me punë e mes përpjekjesh udha jonë ndriçohet.  
Do kemi dhe të meta, pa dhe vështirësi shumë,  
mbrapsh, ai që dhe nga një gjëmb tmerrohet!

Revolucioni ka shkrepë, ka furtunë;  
si një pellg nga shirat, nuk kalohet.

Mbi jetën tonë të gjerë ndikojmë në çdo hap  
dhe s'lëmë që jeta maramenç të vijë;  
Lenini komunistit ia thotë qartë:  
– Drejtoje jetën, jo të të përpijë!

Në vorbullën e saj ne flakim veç lëmishtet;  
kush vjen për privilegje, më mirë të mos mundohet!  
Në vijë të parë të luftës komunisti hidhet,  
njëqind herë ngrihet dhe gjoksi shoshë t'i shpohet!

...Lëvozhgat janë të lehta, zgjedhin brigjet.

Revolucioni ka dallgë  
e... si kafshatë s'kalohet.

## DUKE SHIRË NË LËMË

Ja, mall' i vjetër për të shirë në lëmë  
rishmë se ç'm'u zgjua këtë natë;  
po, ku janë kuajt me trokun e rëndë,  
si dikur, kamxhikun prapë t'ua mat...

...S'ka më turfullim; ky gufar i hekur  
duajt me kallinj përpin dit' e natë...  
Shiva un' gjer vonë, mall'i vjetër  
nuk u zbrazka lehtë... Hyra prapë.

– Duhet, more bir, edhe një kombajnë  
breqetin tonë mbase e mbaron.

...Zbardh yll' i mëngjesit, dritë më çdo anë;  
– Çlodhu, biri ynë, hëna po shalon...

–Dita vjen si nuse edhe ikën prapë,  
ne në kohë fushate, durojmë si hekur.  
Grurin këto ditë do ta bëjmë zap,  
pastaj... bjena bejte, për to... je i thekur!

...Pata shirë dhe unë me kuaj njëherë,  
o, sa bukur ishte edhe sa kujtime...  
Po, si këto netë, kurrë s'kam ndjerë  
brohorinë e jetës mbushur me gëzime!

## KUJTOJE KËTË STROFË

Ta jep në dorë populli dhëmballën,  
kur veten me premtime boshe lan e lyen,  
Ai që s'është' i zoti të mbajë fjalën,  
edhe mbi trëndafila hundën thyen.

## BUKURIA JOTE

Fjalë avash, këmbë nxituar  
kur më shkon shtathijeshuar,  
flokëkorbi, derdhur, shtruar  
përmbi supe. Faqe shkruar  
bor' e gjak, buz' hoj kulluar.

Zemër' e zjarrtë në krahuar  
të rreh me mall të pashuar...

Ti në punë e pa përtuar,  
ti në fjalë e pa dëgjuar;  
kurrë s'je mburrur, e s'je nxituar,  
gojëmjaltë e punë mbaruar.

Gjuhë brisk me cipëshpuarit,  
me dembelë, llafelëshuarit.

Ç'të vështroj?... Dy syt' e zez,  
apo flokët që gremisen  
si një pyll, e arratisen  
prapa krahësh, gjer në brez?...

...Si një pyll e n'atë pyll  
ti më ndrin posi një yll

## XHA TEMJA

- Jetën e zgjat shumë djersa edhe munda,  
gëzim ke kur kënga buzëve të mbin  
pleqëria, bir, është' rini e fundit;  
zemra do dhe vrull, do dhe brohorimë.

## DHEMSHURIA E PLAKUT

*Në ditët e fundit, të jetës, një bari  
kërkoi ta çonin tek sofati për të pa-  
rë tufën e bagëtive të përpjetës së  
shullërit...*

– Krahun, biri im, se vetëm s'ngrihem dot...  
Edhe duke vdekur, dua të vështroj  
kopenë n'ato brigje, kur qetazi kullot.

Më ler gjer në mbrëmje, sytë t'i drejtoj –  
ku hëna argjëndore mbyll synë e bagëtive  
e cula nëpër brinja, me derte ligjëron...

Ku këng' e bejkës bardhë deh shpirtin e barinjve,  
edhe burim' i ftohtë ngadalëz mërmëron...

...Mbama supin, bir, eja ca më pranë...  
Ta hedh ndër ato brigje edhe të fundit mall.

Buzën të ma mbyllë një pëshpërim' e valë:  
– Bjeri fyellit, çoban, more çoban,  
në mos – po... dhe i vdekur  
nuk do gjejë derman!...



## M A R S

Kumbullat kanë çelur,  
dit' e freskët marsi, diell e gëzim;  
pllajave janë derdhur  
zile e këmborë, mbytur brohorimë...

Ngjitem te brezaret me hardhi;  
vreshtat po krasiten, rrënj' më rrënjë spërkaten.  
Pjergullat, drejtvijë –  
veshur në të gjelbër tutje zgjaten...

Dy thëllëza rrinë pranë e pranë,  
belin, lë te ledhi e bëj pak pushim;  
gjethe plepash pliksen palë-palë,  
rrudha-rrudha gruri fërfërin...

## NË LIQENIN E POGRADECIT

Ky qytet' i dashur ndezur dritë,  
zemrës gaz e mall i frymëzon;  
valëz' e liqenit, nat' ditë  
bukurinë e vendit pasqyron...

Hëna shndrit me rrezet që të dehin,  
yjet bien larg nër horizonte;  
dy lopata valët përkëdhelin,  
ky liqeni tjetër ç'do lakmonte?!

## ZBRESIN DHËNTË NGA MALI

Zbresin dhëntë nga mali...

Vërshimë blegërimash që vrapin s'e ndalin,  
fërfërimë gjethesh që freski të falin.

Mërmëritje ujërash që puthen me zallin,  
tingujt e dyjares që gëzim të ngjallin.

Dy bashka me re, qafuar me malin,  
me vrap – dy gërsheta gëzuan luadhin...

Dy vargje me dhën që nga kroi marrin,  
për karshi, dy gjokse si një zemër rrahin...

## EPITAF MBI VARRIN E SMIRËZIUT

Çdo prapësi e ndodhur ambicien i gëzonte,  
gabimet e gjithkujt qenë për të melhem;  
me veten dhe ambientin, i pakënaqur rronte,  
në çdo hap të jetës pik e verem...

Për gëzimin e vërtetë kurrë nuk luftoi;  
çdo ngjarje e keqe, si ngazëllim i vinte.  
Suksesi i të tjerëve përherë e pikëlloi,  
si ndryshku hekurin, smira e përpinte.

Smira edhe kockat një nga një ia bloi,  
aq sa një ditë, tek lajme po priste,  
në pritje të së ligës –  
dhe zemra i pushoi.

## PERËNDIMI I DIELLIT

Perëndim' i gjaktë endet dalngadalë,  
lehtas pelerinën puhiza ia preku,  
ja behu plot mall  
supeve të ndezur nëpër ngjyra...

Trëndafil' i bukur lulëzon te shtegu  
mes jehona isosh po gëzon natyra.

Kthehen vullnetarët me një këngë në gojë,  
venë të bardhët qingja tej nga monopati.  
Ulur buzë një ledhi çlodhem e vështroj,  
një liqen me drita ndezi sonte fshati...

## MOS I FSHIH SYTË NËN QEPALLA

Sado larg teje,  
ata syt' e tu më dalin gjithkund.  
Aty vjen çlodhet  
mendimi im,  
lumturia ime e pafund.

Ta njoha zemrën  
përmes syve të bukur e të menduar,  
mos i fshih nën qepalla  
me shigjeta qerpikësh rrethuar...

## UJËVARAT

Kullosin lopët tej nëpër livadhe,  
dhëntë mërzejnë brinjëve të një shpelle.  
Nga lartësitë, të thinjurit ujëvara  
mendime të pastëra përroit i sjellin...

Bujqit misër vjelin në një pllajë,  
dy baresha venë të mjelin dhitë.  
Rrjedhin mendime mbi përroit e bardhë,  
ujëvarat e thinjura që nga lartësitë.

## ENDËSJA E QILIMAVE SHQIPTARË

Nga dor' e natyrës –  
ortak të tjerë ende s'janë dukur  
si ata qilima që thur me dashuri.

Njeriu, dhe mes qiejve është' futur  
po bukurinë e tokës  
e «vodhe» vetëm ti!...



## FJALA E PARTISË

Dhe malin e shkërmoq e gurin di ta ngjallë,  
mbi çdo tallaz e shqotë vetëm fitore di;  
fjala e Partisë na hynë nëpër damarë,  
i jep krahë të riut, të moçmin bën të ri...

Zemrat tona në çast i kthen në mal,  
kthjellon gjykimin, çdo hije e largon;  
mbledhur e gatuar n'atë fjalë,  
rubini i mendimit popullor.

## JEHON GURRA E PROGONATIT

*Xha Zenelit, babait të Heroit A. Zeneli.*

Buzë mbrëmjes vjen haberi,  
bie fshati në mendime;  
nënës gjoksi se ç'i theri,  
– Bën durim, moj nëna ime...

Dridhet loti tek qepalli,  
honi përcjell oshtimën.  
Malet se ç'i mori malli,  
gurrat prenë gurgullimën.

Vetëtima natën grisi,  
honi zë e uturon...  
Ja, afrohet prap' Sherifi,  
xha Zenelin po dëgjon:

– Merr ti pushkën e gjerdanin,  
nuk pret koha për lëngata;  
nisja këngës për vatanin,  
shkrepash kur të bjerë nata.

Si Asimi, yt vëlla,  
qëndro shkëmb në suferinë.  
S'do më dredhë kurrë mandata  
në dhënç jetën për lirinë.

...Edhe ballin plaku ngre,  
syt' i hedh tej nga zabeli.  
– Të dy djemtë Partisë ia dhe,  
xha Zenel, o xha Zenel!...

## II.

Era, Qafën e Gërxfunit  
e rreh – vu, me tërsëllimë.  
Tej, një zë mes honesh humbi  
dhe u derdh një blegërimë.

Derdhet isua në një pllajë,  
nën qepallë loti dridhet;  
mbi çdo llohë e çdo tufan,  
si një shkëmb Asimi ngrihet.

Qafën e Gërkhunit lloha  
se ç'e rreh me suferinë;  
o, kjo gurra si s'pushoka,  
ujku shpellash ulërin.

...Sokëllimë nëpër shpella,  
nisi bora gjëmëmadhe;  
një llabane ç'e shkund era,  
o llabane, moj llabane...

Të paprera suferinat,  
nëpër brigje se ç'u derdhë;  
plumba – det, me vërshëllima  
nat' e ditë mbi troje erdhë...

Flak' e luftës natën grisi,  
ngjethet bari tek livadhi;  
Shefqet Peçi këngën nisi,  
ndizet nëpër gjokse zjarri...

### III.

Flladi Qafën e Gërkhunit  
e qafon me fërfërimë,  
çeli jeta dhe maj' gurit,  
në çdo ledh e në çdo brinjë.

Vijnë fëmijë si gurgullima,  
lule vënë te lapidari;  
puth puhiza trëndelinat,  
ulen thëllëzat te zalli...

Ja, tarraca nga çdo anë,  
shtyllat përmes grykash ngrihen;  
drit' e diell tejendanë,  
këngët nëpër pllaja krihen...

Ledh'e brigje – brohorima,  
buzë udhës – lapidari...  
Sa çmallet me blegërimat,  
prap, për krojet e zë malli...

– Dil, moj nëna e Asimit,  
nënë je, nëno të thonë;  
i dhe gji e jetë trimit  
dhe hyre në këngën tonë...

Thonë ka zbritur prap' Asimi,  
xha Zeneli pret te zalli...  
për ca djem me çika ylli,  
trimen nënë ç'e mori malli...

– Nënë, moj, ç'je plakur shumë,  
përmbi flokë një nur i bardhë...  
Prite, nise në furtunë  
Bijë e bija partizanë.

#### IV.

Ç'deli – iso, Progonati  
mes flliditjes e afron...!  
...Del Asimi majë një shpati,  
era ballin ia lëmon...

Rri rinuar ndanë udhës,  
derdhur në mermer të bardhë,  
s'të harrojnë kurrën e kurrës,  
komisar, o deli djalë!...

Dredh duhanin xha Zeneli,  
mbrëmjes ulur tek sofati;  
n'ata sy se ç'paska derdhur  
dashurinë e tij gjith' fshati.

Çeta në stërvitje ndodhet,  
xha Zeneli ç'po vështron?...  
Mbrëmjes tek sofati çlodhet,  
zën' e cules ç'e dëgjon.

Sheh me mall nga monopati,  
isos udhëton përmes...  
Del ta shohë gjithë fshati,  
plot gëzim plakun të presë.

Trim, o xha Zeneli trim,  
mbylle jetën me lavdi;  
krah' e fjalë – vetëtimë,  
gjak e zemër për liri.

Ja, mes malesh derdhen rrezet,  
nëpër pllaja fryn veri...  
Prit dhe përcill mëngjeset,  
mal me borë rri ai!

## PASQYRA E LËNDËS

Te varrezat e dëshmorëve .....	3
Mëngjes .....	4
Kur s'kishim të nesërme .....	5
Aromë .....	6
Syri i pushkës .....	7
Kur më përcolli nëna .....	8
Me mendje të kthjelluar .....	9
Vëllimi XIX .....	
Flladi i agimit .....	10
Në çdo stuhi .....	11
Pas kthimit nga puna .....	12
Po vij tek ti .....	13
Udhët tona .....	14
Gjaku i ri .....	15
Mos kërko të dukesh .....	16
Nga kjo baltë .....	17
Martesa e djeshme .....	18
Dy ditë pas martesës .....	19
Ligjëratë kroi .....	21
Varri i tezes sime .....	22
Peizazh .....	23
Udha e komunistëve .....	24
Duke shirë në lëmë .....	25
Kujtoje këtë strofë .....	27



Bukuria jote .....	28
Xha Temja .....	30
Dhemshuria e plakut .....	31
Mars .....	32
Në liqenin e Pogradecit .....	33
Zbresin dhëntë nga mali .....	34
Epitaf mbi varrin e smirëziut .....	35
Perëndimi i diellit .....	36
Mos i fshih sytë nën qepalla .....	37
Ujëvarat .....	38
Endësja e qilimave shqiptarë .....	39
Fjala e Partisë .....	40
Jehon gurra e Progonatit .....	41